



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 639, datë 16.12.2020

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DIBËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Olti Skrame dhe Aurel Arapi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen civile me palë Paditëse e kundërpaditur: Lamiha Besatari; I paditur: 1. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish Pronarëve Tiranë, 2. Musa Selami; i paditur kundërpaditës: 1. Petrit Shehu, 2. Zeqi Shehu, etj,

Person i tretë: 1. ZVRPP Dibër, Bashkia Dibër, Kimete Mehmeti, etj.

Objekt padie: Detyrimin e palëve të paditura të më njohin pronar si trashëgimtarë të të ndjerit babait tim Besim Shehu, në pronën e ndodhur në qytetin e Peshkopisë, 2. Anulimin e pjeshëm të vendimit të K.K.K.P. nr. 45, datë 01.08.1994 për njohjen e pronësisë, etj.

Objekti i kundërpadisë: Pavlefshmërinë e vendimit nr. 126, datë 13.07.2000 të K.K.K.P. pranë Këshillit të Qarkut Dibër, Kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN

1. Gjyqtaret e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Arnisa Këlliçi dhe Elisabeta Gjoni, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin; I pandehur: Ilir Xhepaj (Lika); Akuza: Nenet 76 e 22 dhe 278/1 të Kodit Penal dhe të pandehurit Gaspër Gashi (Gjeta), i akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Elisabeta Gjoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: Brisild Çapani; Akuza: “Neni 283/2 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR MAT

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Xhevdet Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: Petrit Murrani; Akuza: “Nenet 324/a/2 të Kodit Penal”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Edvan Veçani dhe Ardit Kuka, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: Sebasion Kola; Akuza: “Neni 76 e 22, 278/1/2/4, 274 dhe 84 të Kodit Penal”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Armela Hasantari (relatore), Lazër Sallaku dhe Artan Gjermani, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: Tori (Hektor) Xhecuka (Xhecuka); Akuza: “Nenet 76-22, 278/1 të Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Eda Kaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: Xhevdet Lecini; Akuza: “Neni 76 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Thomaidha Roça, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: Klinton Merxho, Kejvi Velo; Akuza: “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjergji Baçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; Objekti: “Gjykimin e procedimit penal nr. 376, të vitit 2019, ndaj të pandehurit Leonard Nelo Koçi dhe Julian Përparim Shehu, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283, paragrafi i dytë, i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR

1. Refuzimin e shqyrtimit të kërkesës nr.311 prot., datë 09.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për caktim gjyqtari, në çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: Elida Lamçe, etj; akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Pastrim i produkteve të veprës penale”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Marjola Beluli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, çështjen penale në

ngarkim të të pandehurit: Taulant Alushaj; Akuza: “Prodhim dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 të Kodit Penal.

GJYKATA E APELIT DURRËS

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: Kevin Mburimi, Rei Hodo, etj.; Akuza: “Nenet 278/6, 283/2, 284, 300/1 të Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me kërkuese: Gjelinë Doçi; Objekti: “Përjashtim gjyqtari”.

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Vojsava Osmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me kërkues: Satilno Basho; Objekti: “Përjashtim gjyqtari”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR